

GJYKATA E APELIT

Çështja numër: PAKR 4/2013

Data: 22 Tetor 2013

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS në Kolegjin e Gjyqtarëve në përbërje të Gjyqtarit të EULEX-it Tore Thomassen, në cilësi të Gjyqtarit Kryesues dhe Gjyqtarit Raportues, Gjyqtares së EULEX-it Annemarie Meister dhe Gjyqtares së Gjykatës së Apelit, Tonka Berisha në cilësi të anëtareve të Kolegjit, me pjesëmarrjen e Andres Parmas, Zyrtar Ligjor i EULEX-it, në cilësi të Procesmbajtësit, në çështjen penale kundër

J. P. i biri i xxx dhe xxx; i lindur më xxx në xxx, Serbi, shtetas i Serbisë, me banim në xxx, xxx, i pamartuar; pa histori penale, në paraburgim që nga data 17 Maji 2011. **J. P.** akuzohet me 1) Kontrabandim të mallrave, në kundërshtim të Nenit 273 (1) të KPK-së; 2) Shmangie nga Tatimi, në kundërshtim të Nenit 249 (1) dhe 92) të KPK-së; 3) Shmangie Mashtruese nga Tatimi i Importit dhe akcizës, në kundërshtim të Nenit 298 të Kodit të Doganës dhe të Akcizës; 4) Spastrim të Parave, në kundërshtim të Nenit 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2 mbi Pengimin e Spastrimit të Parave dhe Veprat e Ndërlidhura Penale; 5) Krim i Organizuar, në kundërshtim të Nenit 274 (1) dhe (2) të KPK-së; dhe 6) Mbajtje, Kontroll Posedim dhe Përdorim i Pa-autorizuar i Armëve në kundërshtim të Neni 328 (2) të KPK-së.

Duke vepruar mbi Ankesën e Mbrojtjes kundër Aktgjykimit P 45/10 të parashtruar në Gjykatën e qarkut të Mitrovicës më datë 3 Dhjetor 2012;

Pas shqyrtimit të Përgjigjes ndaj Ankesës së Prokurorit Special të parashtruar me postë më datë 31 Dhjetor 2012 dhe Mendimin dhe Kërkesën e Prokurorit Shtetëror të Ankesave të Kosovës, Claudio Pala, të dorëzuar më datë 24 Qershor 2013;

Pas mbajtjes së seancës më datë 3 dhe 22 Tetor 2013 në praninë e Prokurorit Shtetëror të Ankesave, Judit Eva Tatrai, të Pandehurit **J. P** dhe Avokatit të tij Mbrojtës Zh.J.;

Pas mbajtjes së pleqërimit dhe votimit më datë 22 Tetor 2013

Në pajtim me Nenet 420 (1.4) dhe 426 (1) të Kodit të Procedurës penale të Kosovës (KPPK-së)

Lëshon si në vijim, këtë

AKTGJYKIM

1. Aktgjykimi i Gjykatës së qarkut të Mitrovicës e datës 20 Shtator 2012 në çështjen penalë nr. 2/2012 është modifikuar si në vijim:

1.1. Aktakuza hidhet poshtë në pjesën ku J.P. akuzohet me mbajtje, kontroll, posedim dhe përdorim të pa-autorizuar të armëve, në kundërshtim të Nenit 328 (2) të KPK-së.

1.2. Përcaktimi ligjor i veprave të atribuara J.P. është ndryshuar si në vijim, në pajtim me Nenin 420 (1) 4 dhe 426 (1) të KPPK-së.

1.2.1. Anullohet dënimi i J.P. në çështjen penale të spastrimit të parave në kundërshtim me Nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut me numër 2004/2 mbi Parandalimin e Spastrimit të Parave dhe Veprave penale që Ndërlidhen me këtë.

1.2.2. J.P. është dënuar për krim të organizuar në kundërshtim të Nenit 274 (1) dhe (2) të KPK-së në lidhje me spastrimin e parave, në kundërshtim të Nenit 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut me numër 2004/2 mbi Pengimin e Spastrimit të Parave dhe Veprave Penale që Ndërlidhen.

1.3. J.P. është dënuar me 4 (katër) vjet burgim dhe me gjobë 1000 Euro.

1.4. Anullohet vendimi i Gjykatës së Qarkut që bazohet në Nenin 60 (1) dhe (2) për konfiskim të makinës Mercedes i zi me regjistrim xxx dhe makinës Volkswagen me regjistrim xxx.

2. Konfirmohet pjesa e mbetur e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës të datës 20 Shtator 2012.

3. Ankesa miratohet pjesërisht siç është cekur më lartë.

ARSYETIM

I. Historia Procedurale

1. Më datë 13 Tetor 2010, prokurori ka lëshuar një aktvendim mbi Inicimin e Hetimeve në çështjen me numër PPS 41/2010 kundër disa të dyshuarve, duke përfshirë **J.R.**, i cili është akoma na arrati. Më datë 10 Nëntor 2010, Prokurori lëshoi një Aktvendim mbi Zgjerimin e

Hetimeve ndaj **S.D.**, i cili është akoma në arrati. Më datë 15 Shkurt 2011, Policia e EULEX-it me ndihmën e KFOR-it ka kryer një bastisje të quajtur “xxx” . Provat e siguruar gjatë këtij operacioni çuan Prokurorin për të lëshuar një Aktvendim mbi Zgjerimin e Hetimeve në këtë çështje ndaj të pandehurit **J.P.** më datë 28 Mars 2011.

2. Pas zgjerimit të hetimeve më datë 26 Prill dhe 16 Maj 2011 Gjyqtari i Procedurës Paraprake i EULEX-it dha Urdhër për Arrestim dhe Urdhër për Bastisje, të dyja me datë 16 Maj 2011, pas kërkesës së Prokurorit. Më datë 17 Maj 2011 Policia e EULEX-it ka kryer operacionin e ashtuquajtur “Tambora”, e cila rezultoi me arrestimin e të Pandehurit. Qe atëherë i Pandehuri ka qëndruar në paraburgim. Më datë 14 Tetor 2011, Gjyqtari i Procedurës Paraprake miratoi zgjatjen e hetimeve deri më datë 13 Prill 2012.
3. Prokurori ngriti Aktakuzën PPS Nr. 41/2010 kundër **J.P.** më datë 10 Nëntor 2011/ Ai akuzohej me veprat penale si në vijim:
 - 1) Kontrabandim i mallrave, në kundërshtim me Nenin 273 (1) të KPK-së;
 - 2) Shmangie të Tatimit, në kundërshtim të Nenit 249 (1) dhe (2) të KPK-së;
 - 3) Shmangie mashtruese e tatimit doganor dhe akcizës, në kundërshtim të Nenit 298 të Kodit të Doganave dhe të Akcizës;
 - 4) Spastrim parash, në kundërshtim të Nenit 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut me numër 2004/2 mbi Parandalimin e Spastrimit të Parave dhe Veprave Penale që Ndërlidhen me të.
 - 5) Krim të Organizuar, në kundërshtim të Nenit 274 (1) dhe (2) të KPK-së; dhe
 - 6) Mbajtje, kontroll, posedim dhe përdorim të pa-autorizuar të armëve, në kundërshtim të Nenin 328 (2) të KPK-së.
4. Aktakuza u konfirmua me Aktvendimin KA nr. 201/11 më datë 20 Janar 2012. Gjyqtari i Konfirmimit shpalli të gjitha provat si të pranueshme. Aktvendimi i Gjyqtarit të Konfirmimit nuk është atakuar.
5. Gjykimi kundër **J.P.** u mbajt para publikut përballë trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës të përbërë nga 2 Gjyqtarë të EULEX-it dhe një Gjyqtar Kosovar në periudhën në mes 15 qershorit dhe 20 Shtatorit 2012, të gjitha në prani të të Pandehurit, Avokatit të tij Mbrojtës dhe Prokurorit.
6. Aktgjykimi kundër **J.P.** u shpall më datë 20 Shtator 2012.
7. I Pandehuri **J.P.** u shpall fajtor për veprat penale të spastrimit të parave në kundërshtim të Nenit 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut me numër 2004/2 mbi Ndalimin e Spastrimit të Parave dhe të Veprave Penale që ndërlidhen me të; Krimin të Organizuar, në kundërshtim të Nenit 274 (1) dhe (2) të KPK-së; dhe Mbajtjes në Kontroll, Posedim, ose Përdorim të Pa-autorizuar të Armëve në pajtim me Nenin 328 (2) të KPK-së.

8. **J.P.** u dënua me 4 (katër) vjet burgim dhe po ashtu me një gjobë 1000 Euro për spastrim të parave; 8vjet burgim dhe po ashtu me një gjobë 1000 Euro për krim të Organizuar dhe 1 vit burgim për mbajtje, kontroll, posedim dhe përdorim të pa-autorizuar të armëve . Dënimi unik i përcaktuar ishte 9 vjet burgim dhe gjobë 2000 Euro. Koha e kaluar në paraburgim u llogarit. Në pajtim me Nenin 328 (5) të KPK-së arma ilegale në pronësi të **J.P.** u konfiskua. Në përputhje me nenin 60 (1) dhe (2) KPK-së, dy automjete dhe para kesh në valutat euro dhe dinarë serb të marra nga i pandehuri në rastin e arrestimit të tij më 17 maj 2011 ishin konfiskuar. I pandehuri ishte obliguar që t'i mbulojë shpenzimet e procedurës penale në përputhje me nenin 102 (1) të KPPK-së.
9. **J.P.** u lirua nga vepra penale e; kontrabandimit të mallrave, në kundërshtim të Nenit 273 (1) të KPK-së; shmangies së Tatimit në kundërshtim të Nenit 249 (1) dhe (2) të KPK-së; dhe shmangies mashtruese të tatimit doganor dhe akcizës, në kundërshtim të Nenit 298 të Kodit të Doganave dhe të Akcizës.
10. Avokati Mbrojtës, Zh.J. ., në emër të **J.P.** . parashtroi një ankesë më datë 3 Dhjetor 2012. Më datë 31 dhjetor 2012 Prokurori Special parashtroi (me vonesë) një përgjigje nga ankesës me postë. Më datë 24 Qershor Prokurori Shtetëror i Apelit të EULEX-it, Claudio Pala parashtroi një Mendim dhe Kërkesë në Përgjigje ndaj Ankesës.

II. Parashtrësat e Palëve

A. Ankesa e Avokatit Mbrojtës

11. Avokati Mbrojtës i **J.P.** i propozoi që Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të anulohet dhe i Pandehuri të lirohet ose çështja të kthehet për rishqyrtim, ose i pandehuri të dënohet më lehtë. Ai pretendon se 1) ka shkelje serioze të normave të procedurës penale në aktgjykimin e kontestuar; 2) e drejta material është aplikuar gabimisht; 3) faktet janë përcaktuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë; dhe 4) rregullat e shqiptimit të dënimit janë shkelur. Në mënyrë më specifike, argumentet e Avokatit Mbrojtës janë si në vijim.
12. Ushtruesi i Ankesës pretendon se dispozitivi i aktgjykimin të kontestuar është i paqartë dhe në kundërshtim me arsyetimin. Mungojnë arsye mbi faktet vendimtare dhe arsyetimi është vet kundërshtues. Sipas Avokatit Mbrojtës nuk ka përshkrime të dhëna mbi kryerjen e veprës së spastrimit të parave në Aktgjykimin e Kontestuar, përveç kësaj supozohet se ë proces të këmbimit të parave një veprim i spastrimit të parave është kryer, sepse paraje e këmbyer ka buruar nga veprimtaria kriminale e njerëzve të tjerë (shmangie e tatimit, krimet e kontrabandimit). Avokati Mbrojtës po ashtu mendon se dispozitivi i Aktgjykimin të

Kontestuar është i zbehtë duke përcaktuar **J.P.in** së bashku me personat e tjerë dhe shoqëritë se një anëtarë i grupit kriminal të organizuar që kontrabandën mallra në Kosovë dhe i shmanget tatimit doganor, si dhe tatimit të akcizës. Kjo është kontradiktore sepse **J.P.i** ishte liruar nga veprat penale të cekura të kontrabandimit dhe të shmangies së tatimit.

13. Provat e paraqitura janë vlerësuar gabimisht, gjë që çon në konkludim të gabuar lidhur me veprimet e të Pandehurit. Gjendja e fakteve në lidhje me llojin, sasinë dhe vlerën e mallrave është përcaktuar sipas provave të pranuara (vlerësimi i mallrave të importuara – lidhur me veprat penale të kontrabandimit dhe shmangies së tatimit, nga të cilat **J.P.** ishte liruar). Dëshmitarët kryesisht mohuan ndonjë përfshirje të **J.P.** në këto vepra penale. Provat (po ashtu sipas deklaratave të J.P.) tregojnë se ai nuk kishte njohuri se si bëhej importimi i mallrave dhe ai përfundimisht nuk morri pjesë në këtë. Sipas Mbrojtjes, përdorimi i deklaratave të **J.P.** në fazën e procedurës paraprake ishte gabim, sepse ai është përcaktuar të heshtë në gjykatë. **J.P.** është shpallur fajtor nga Neni 328 të KPK-së pa asnjë provë. Nuk është përcaktuar nga gjykata në bazë çfarë provash shuma bruto e tregtisë së pretenduar të mallrave të kontrabanduara arriti 9 000 000 Euro. Gjykata nuk do të duhej të pranonte një argument të tillë të prokurorisë. Mallrat nuk janë kontrabanduar në Kosovë, por janë sjellë legalisht nëpërmjet pikave kufitare dhe janë regjistruar në mënyrë të duhur.
14. Vepra e spastrimit të parave nuk është dëshmuar. **J.P.** nuk ishte në dijeni se ai kryente veprë penale; ai nuk kishte paramendim e as motiv për të kryer një krim. Në fakt nuk mund të ekzistojë vepra e spastrimit të parave sepse për të spastruar paratë, e nevojshme është që kryesi të jetë në dijeni të veprës penale që është duke e kryer dhe do të duhej të ishte në dijeni se prona e kontestuar është rezultat i ndonjë veprimtarie kriminale. Kjo nuk është përcaktuar në rastin e **P-it**. Ai thjeshtë kreu urdhrat e atyre që e caktuan dhe krijoi një përfitim të vogël nga këmbimi i valutës dhe duke bërë pagesa për vajra.
15. As posedimi i armëve nuk është dëshmuar. Shenjat e gishtave në mbajtëse nuk janë provë e mjaftueshme të dëshmohet fajësia për këtë shkak. Në të vërtetë, i Pandehuri vetëm ia kishte dhënë mbajtësen e pa përdorur vëllait të tij tani më shumë vite para krimit të pretenduar.
16. Ushtuesi i ankesës është i mendimit se duke e shpallur **J.P.** fajtor për veprë penale të krimit të organizuar, do të duhej të përcaktohej se ekzistonte një vendim dhe marrëveshje e përbashkët për të kryer veprën penale në mes disa individëve, roleve të ndara dhe udhëheqjes – asgjë e tillë nuk është dëshmuar në këtë çështje në fjalë. Nuk ka prova në lidhje me kënd, dhe në ç'mënyrë grupi i organizuar, dhe kush e udhëhiqte atë, etj. Prandaj nuk ekziston grup dhe shih për këtë nuk ka veprë në kuptim të Nenit 274 të KPK-së **J.P.** operonte në mënyrë të pavarur dhe nuk i takon ndonjë grupi.

17. Ushtruesi i ankesës mendon se spastrimi i parave nuk mund të jete bazë e krimit të organizuar, sepse minimumi i dënimit për këtë veprë penale është më pak se 4 (katër) vjet burgim dhe kjo është kushti më i ulët për Nenin 274.
18. **J.P.** është dënuar gabimisht për mbajtje në posedim të një revole në kundërshtim të Nenit 328 të KPK-së, për shkak të faktit se nuk ishte në posedim të revoles; u dëshmuua se revolja në të vërtetë ishte në pompën e benzinës gjatë periudhës 25 Janar – 15 Shkurt 2011 dhe jo në duart e **J.P.**.
19. Ushtruesi i ankesës lë të kuptohet se vlerësimi i gjykatës mbi sasinë dhe vlerën e mallrave të importuara nuk mbështetet në provat, por mbështetet vetëm në prezumime dhe nuk është e bindshme madje as në teori, sepse nuk ekziston kapacitet që përmban sasinë e pretenduar të produkteve të derivateve në Kosovën veriore dhe madje as për së afërmi konsumi aq i madh të produkteve të vajrave në atë regjion. Mbrojtja pretendon se mallrat (në sasinë e cekur nga gjykata) sipas të gjitha gjasave ka tejkalluar kufirin vetëm në letër.
20. Lidhur me akuzat e spastrimit të parave, veprimet e kryera nga i Pandehuri ishin të gjitha legale dhe të dokumentuara. Ai madje nuk kishte dyshim dhe në fakt nuk do të duhej të kishte dyshim se paratë mund të kishin origjinë nga veprimet e paligjshme. Ai nuk kishte të bënte absolutisht fare me ndonjë veprim që i paraprinë detyrave të veta teknike të këmbimit të valutës dhe transaksioneve bankare. Transaksionet ishin ekonomikisht të nevojshme sepse të ardhurat në Kosovë ishin në Euro, por furnizuesit në Serbi pranonin vetëm dinarët. Konkludim i gjykatës lidhur me rolin e tij primar është e pa bazë. Fakti se **J.P.** operonte një këmbimore të licencuar nuk do duhej të shpjegohet në dëm të tij., sepse kjo është praktikë e rëndomtë në gjithë vendin. Ajo çfarë është relevante është se ai ishte në pronësi të zyrës publikisht. Mbrojtja pretendon se spastrimit të parave zakonisht i paraprijnë disa veprime kriminale që përfshinë korrupsionin, por kjo nuk është përcaktuar në këtë rast. Tregtia me mallra, mbi të cilën ekziston dokumentacioni i plotë nuk mund të futet në kuadër të institucionit të spastrimit të parave. Asnjë person me mend në kokë nuk do të spastronte para në mënyrë kaq primitive siç ka vepruar i Pandehuri. Për këtë arsye përjashtohet se **J.P.** (Jevro Pantelić) ka kryer veprë penale të spastrimit të parave.
21. Ushtruesi i ankesës tërheq vëmendjen në kërkesën se konkludimi gjykatës nuk do të duhej të bazohet mbi arsyetimin që nuk lë vend për dyshim, përndryshe parimet e prezumimit të pafajësisë dhe *in dubio pro reo* do të shkeleshin.
22. Në lidhje me dënimin, Avokati Mbrojtës shpreh mendimin e tij se dënimi është tanimë i gabuar për shkak të shkeljes procedurale dhe ligjit material dhe përcaktimit të gabuar të fakteve. Po ashtu ishte një shkelje e ligjit penale të shpallet dënimi unik thjesht duke shtuar dy gjoba nga 1000 Euro. Ai po ashtu thekson se gjykata ka konstatua gabimisht rrethanat

rënduese në vlerat arbitrare, të cilat kurrë nuk janë përcaktuar (sasia e parave të spastruara, periudhës kohore të kryerjes së veprës, frekuenca e veprave individuale, po ashtu fakti se ai ishte anëtar i një grupi kriminal). Ishte gabim të shihet si rrethanë rënduese në lidhje me armën në pronësi në mënyrë joligjore, se arma paska qenë në posedim të paqëndrueshëm. Kjo nuk mund të përbëjë një rrethanë rënduese sepse është element përbërës i veprës penale të përcaktuar në Nenin 328 të KPK-së. Ushtruesi i ankesës thekson se ndryshe nga rrethanat rënduese faktorët lehtësues vetëm janë cekur, por Gjykata e qarkut nuk i ka dhënë ndonjë peshë.

B. Përgjigja ndaj Ankesës

23. Prokurori Special i EULEX-it në përgjigjen e tij kërkon që ankesa të hidhet poshtë si e pa bazë kurse dënimi i **J.P.** të mbështetet. Prokurori konstaton se argumenti i ushtruesit të ankesës nuk ka në renditje logjike dhe pjesërisht madje as që është vendosur në baza të sakta ligjore. Ai pretendon se gjetjet faktike dhe arsyetimi ligjor i Gjykatës së Qarkut mbështet përfundimet që janë nxjerrë në Aktgjykim. Sa i përket bazave specifike ligjore që pretendohet se janë shkelur nga Gjykata e qarkut, Prokurori pohon si në vijim.
24. Nuk ka ndodhur asnjë shkelje e normave procedurale. Aktgjykimi është i qartë dhe konciz; nuk ka mospërputhshmëri brenda dispozitivit ose në mes të dispozitivit dhe arsyetimit. Çdo konkludim i Gjykatës së qarkut është i bazuar. Në mënyrë specifike, në lidhje me akuzat mbi spastrimin e parave, dispozitivi dhe arsyetimi (par 9.2 (e)) përmbajnë përshkrime të sjelljes kriminale të të Pandehurit dhe gjetjeve të provave në lidhje me veprën penale. Prokurori nuk pajtohet me ushtruesin e ankesës se Aktgjykimi i Kontestuar është i bazuar në mos pranueshmërinë e provave, duke theksuar se tanimë arsyetimi në lidhje me bazën e papranueshmërisë së pretenduar është i paqartë, mbrojtja nuk ka arritur të ngritë argumente me kohë gjatë gjyqimit dhe sidoqoftë po ashtu nuk ka bazë për pretendime të tilla. Të gjitha provat janë pranuar dhe peshuar në mënyrë korrekte. Pohimet e mbrojtjes në lidhje me siç pretendohet pranimin e gabuar të deklaratave të të Pandehurit në fazën e procedurës paraprake është gabim dhe Gjykata e qarkut kishte të drejtë të mbështetet në provat madje në situatën ku i Pandehuri është përcaktuar për taktikë mbrojtëse duke mbetur në heshtje gjatë gjyqimit.
25. Ushtruesi i ankesës në mënyrë të gabuar pohon se i Pandehuri nuk merrej me të ardhura nga krimi, sepse jo ai vet e as ndonjë anëtar tjetër i grupit të pretenduar kriminal nuk kishin kryer ndonjë vepër penale të pre supozuar, domethënë kontrabandë e mallrave. Sipas Prokurorit, interpretimi korrekt i ligjit tregon se kontrabandimi mallrave me të vërtetë është kryer. Është konkludim i pa rëndësishëm se veprimet ilegale ishin publikisht të njohura dhe toleroheshin nga autoritetet. Prokurori po ashtu nuk pajtohet me ushtruesin e ankesës se **J.P.** nuk e kishte ndërmend të kryej spastrimin e parave sepse nuk ishte në dijeni të veprimeve kriminale

themelore. Gjykata e qarkut ka konstatuar në mënyrë të saktë se është dëshmuar përtej dyshimit të bazuar se ai në fakt ka qenë në dijeni të plotë lidhur me veprimet e bashkë kryesve dhe e kishte për qëllim të kryej spastrimin e parave. Prokurori është i mendimit se Gjykata e Qarkut në mënyrë të drejtë ka shpallur të Pandehurin fajtor për veprën penale të krimit të organizuar. Pohimi i ushtruesit të ankesës se kjo tani më është përjashtuar nga fakti se spastrimi i parave nuk mund të konsiderohet krim i organizuar nuk vlen. Argumenti i Avokatit Mbrojtës se nuk ka prova të mjaftueshme mbi ekzistimin e gripit kriminal të strukturuar është në kundërshtim me provat voluminoze të prezantuar në shqyrtimin kryesor, gjë që nuk u sfidua nga Avokati Mbrojtës.

26. Prokurori nuk pajtohet me argumentin e mbrojtjes se Trupi Gjykues ka përcaktuar në mënyrë të pasaktë dhe jo të plotë faktet materiale lidhur me kalkulimin e shumës së shmangies së tatimit dhe të shumës së përgjithshme të të ardhurave që janë spastruar nga i pandehuri. Sipas Prokurorit ekzistonin dokumente të detajuara dhe analiza të dorëzuara në prova, të cilat në bazë të provave dokumentare në shkresat e lëndës ë mënyrë të qartë mbështesin gjetjet e Trupit Gjykues sa i përket fajit të të Pandehurit. Ushtruesi i ankesës kurrë nuk e ka kontestuar këtë provë gjatë gjykimit. Ushtruesi i ankesës po ashtu është gabim kur konteston se dënimi sa i përket posedimit ilegal të një arme nuk ka prova. Në lidhje me këtë Prokurori i referohet në veçanti provës së ADN-së dhe deklaratës konfirmuese nga dëshmitari S.A., gjë që në mënyrë të qartë dëshmon se i Pandehuri në të vërtetë kishte kryer këtë vepër penale.
27. Pretendimet e ushtruesit të ankesës lidhur me dënimin janë pa meritë. Për ndryshim nga argumentet e paraqitura nga Avokati Mbrojtës, Trupi Gjykues përcakton secilën rrethanë rënduese dhe lehtësuese që ka marr parasysh. Dënimi unik u caktua në mënyrë të drejtë duke iu referuara në mënyrë të duhur këtyre faktorëve. Fakti se Trupi Gjykues i ka dhënë më pak peshë faktorëve lehtësues se sa dëshirohej nga ushtruesi i ankesës, nuk mund të gjejë bazë për ankesë.

C. Mendimi i Prokurorit Shtetëror i Apelit

28. Me datë 24 Qershor 2013, Prokurori i Apelit, Claudio Pala ka dorëzuar mendimin si përgjigje ndaj Ankesave. Ai kërkoi nga Gjykata e Apelit të hedh poshtë Ankesën dhe të konfirmojë Aktgjykimin e Kontestuar. Prokurori i Apelit vështron se njohuria e të Pandehurit për veprimet kriminale të grupit mund të konkludohet jo vetëm nga dokumentet e konfiskuara nga i Pandehuri, por po ashtu nga provat e masave të vëzhgimit, mënyra e përhershme dhe e rregullt e veprimit të të pandehurit me para që i ka marr nga personat e tjerë, të pranuarit e të Pandehurit se ishte në dijeni për origjinën e parave, pagesat që ia ka bërë i Pandehuri policisë dhe stafit të kufirit, dhe përfundimisht bashkëpunimi i të Pandehurit me J.R. madje duke qenë në dijeni se R. ishte në kërkim nga policia për

veprimtari kriminale. Prokurori i Apelit nuk u pajtua me pretendimet e Avokatit Mbrojtës sikur sasia e të ardhurave nga veprimtaria kriminale e përcaktuar nga Gjykata e Qarkut është e bazuar në kalkulime jo reale, duke dëshmuar se ekzistojnë prova të dokumentuara të mjaftueshme më mbështetje të këtij konkludimi. Prokurori i Apelit po ashtu shprehu pikëpamjen e tij se fakti i kontrabandimit të produkteve të vajit në Kosovë në mënyrë të saktë është konstatuar nga ana e Gjykatës në bazë të provave.

III. Gjetjet e Trupit Gjykues

A. Çështjet e Përgjithshme

29. Ankesa është parashtruar nga një person i autorizuar dhe me kohë.
30. Në fillim duhet të theksohet se për shkak që Apeli është strukturuar në mënyrë të dobët, argumentet e ushtruesit të Ankesës nuk kanë renditje logjike dhe pjesërisht janë titulluar gabimisht, Gjykata e Apelit konstaton se është e pamundur të ndiqet në tërësi struktura e Ankesës në analizën e saj më poshtë. Prandaj, një numër i pohimeve të ngritura nga ushtruesi i ankesës i përgjigjen bazave të ndryshme ligjore nga ato të propozuara nga Avokati Mbrojtës.
31. Një çështje tjetër që duhet ngritur, para se të analizojmë argumentet e ushtruesit të ankesës, ka të bëjë me efektin e Ligjit Nr. 04/L-209 mbi Amnistinë (Ligji i Amnistisë) në rastin aktual. Ky akt ligjor është shpallur nga Presidentja e Republikës së Kosovës më datë 18 Shtator 2013 dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës / Nr.39 më datë 19 Shtator 2013. Prandaj, ligji ka hy në fuqi më datë 4 Tetor 2013. Në pajtim me Nenin 2 (1) të Ligjit mbi Amnistinë të gjithë ushtruesit e veprave penale të cekura në Nenin 2=3 të këtij ligji që janë kryer para datës 20 Qershor 2013 do të gëzojnë përjashtim nga ndjekja penale ose nga ekzekutimi i dënimit për vepra penale të tillë, në përputhje me kushtet e Nenit 3 të këtij Ligji. Sipas Nenit 3 (1.2.5.) po ashtu veprat penale të mbajtjes së pa autorizuar, kontrollit ose posedimit të armëve në kundërshtim të Nenit 328 (2) të KPK-së bijnë në kuadër të amnistisë. Për shkak se **J.P.** ka kryer veprën penale të posedimit të pa autorizuar para datës së cekur në Nenin 2 (1) të Ligjit të Amnistisë, ai duhet të veçohet nga ndjekja penale në lidhje me këtë vepër penale.
32. Për arsytet e sipër përmendura Gjykata e Apelit e hedh poshtë akuzën e veprës penale të mbajtjes, kontrollit ose posedimit të paligjshëm të armëve në kundërshtim të Nenit 328 (2) të KPK-së kundër **J.P.** . Prandaj, argumentet e ushtruesit të ankesës që kanë të bëjnë vetëm me dënimin e **J.P.** sipas Nenit 328 (2) të KPK-së nuk trajtohen më poshtë.
33. Lidhur me argumentet e ngritura në ankesë, Gjykata e Apelit pohon si në vijim.

B. Shkelja e pretenduar e ligjit procedural

34. Gjykata e Apelit nuk pajtohet me argumentin e paraqitur nga ushtruesi i ankesës se Gjykata e Qarkut ka shkelur në mënyrë qenësore normat e ligjit procedural.

35. Avokati mbrojtës e konteston aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut për shkak të: 1) kundërthënieve ndërmjet diapozitivit dhe arsytimit të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut dhe 2) gjithashtu edhe brenda arsytimit të aktgjykimit. Kundërthënie të tilla mund të shihen vetëm në situatë ku ka mospërputhje logjike ndërmjet konkluzioneve të artikuluara nga Gjykata në dispozitiv dhe arsytimin e fakteve të aktgjykimit ose ndërmjet fakteve të ndryshme të konstatuara nga gjykata. Megjithatë, ky kolegji nuk gjetur asnjë mospërputhje të tillë në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut. Thjesht fakti se avokati mbrojtës nuk pajtohet me konkluzionet e nxjerra në aktgjykimin e kontestuar nuk përbën shkelje në të cilat pretendon ai.

36. Gjykata e Apelit nuk pajtohet poashtu me pretendimin e palës ankuese se aktgjykimi i kontestuar është i paqartë dhe i mungon arsytimi mbi faktet vendimtare. Ky kolegji është i mendimit se arsytimi i Gjykatës së Qarkut mund të ndiqet lehtë, është logjik dhe konsekuent. Të gjitha konstatimet e Gjykatës së Qarkut janë të bazuara mirë dhe qëndrojnë në baza të forta faktike. Prandaj, akuza se aktgjykimi i kontestuar është i paqartë nuk ka bazë. Pozita e palës ankuese se provat e papranueshme janë përdorur për dënimin e të pandehurit nuk qëndrojnë. Në fillim duhet të theksohet atë çfarë ka deklaruar avokati mbrojtës shprehimisht në seancë, respektivisht se ai nuk e konteston asnjë provë të paraqitur nga prokuroria. Ta ndryshosh këtë qëndrim tek në ankesë, është qartë e vonuar, joprofesionale dhe në dritën e dëshmimeve reale jo meritore. Kritika kryesore e palës ankuese kundër provave është se është gabim të mbështetemi në inventarin e mallrave për krimet për të cilat pandehuri është shpallur jo fajtor. Mbrojtja nuk thekson në mënyrë specifike se pse kjo dëshmi është e papranueshme. Arsyeja për këtë nuk mund të jetë thjesht fakti se i pandehuri u lirua nga akuzat e kontrabandimit, si dhe akuzat e shmangies së detyrimeve doganore, akcizave dhe taksave. Gjykata e Apelit konstaton se pavarësisht faktit se **J.P.** nuk është shpallur fajtor për veprat e lartpërmendura penale, provat lidhur me kryerjen e këtyre veprave penale janë relevante për të sjellë vendim mbi fajësinë e tij në aktivitetet e pastrimit të parave dhe krimet të organizuar. Ekzistenca e këtyre veprave penale bazë është një element i rëndësishëm që tregon se **J.P.** ka operuar qëllimisht me të ardhurat që kanë për burim aktivitetet kriminale. Sasia e mallrave të kontrabanduara dhe masa e shmangies nga detyrimet doganore, akcizat dhe taksat është provë përforcuese për konstatimin e shumës së të ardhurave kriminale të cilat i ka pastruar i pandehuri. Ky është gjithashtu faktor i cili kontribuon gjatë përcaktimit të saktë për shkeljen që e ka bërë i pandehuri.

37. Ushtruesi i ankesës gabimisht pohon se vlerësimi ligjor i Gjykatës së Qarkut se mallrat me të vërtetë janë kontrabanduar në Kosovë dhe nuk janë importuar në mënyrë legale, në një mënyrë apo tjetër do përbente shkelje të ligjit procedural. Është detyrë parësore e trupit gjykues të bëjë

vlerësimin e argumenteve ligjore dhe të bëjë cilësimin e fakteve. Këtë e ka bërë Gjykata e Qarkut në rastin konkret dhe kjo nuk përbën në asnjë mënyrë shkelje të ligjit procedural.

38. Ushtruesi i ankesës nuk shpjegon se në çfarë mënyre dispozitivi është i paqartë kur e liron **P.** nga akuzat për kontrabandë dhe shmangie nga tatimet, por prapë duke e dënuar atë për akuzë të krimit të organizuar. Është e qartë nga dispozitivi se për çfarë është shpallur fajtor dhe për çfarë është liruar. Arsyetimi gjithashtu e thotë qartë se pse është kështu. Pjesa e **J.P.** në aktivitetet e grupit të organizuar kriminal është konstatuar të ketë pasur rolin e një njeriut të parave. Ai qëndronte prapa operacioneve financiare me të ardhura nga shitjet mallrat e kontrabanduara dhe kështu me të drejtë konsiderohet një pjesëtar i grupit të organizuar kriminal.

39. Avokati mbrojtës gjithashtu gabon kur jep si argument se deklaratat e të akuzuarit në procedurën paraprake gjykata nuk mund t'i ketë marrë parasysh, kur i pandehuri ka zgjedhur të mbetet në heshtje gjatë gjykimit. Nëse i pandehuri ka dhënë dëshmi gjatë rrjedhës së procedurës dhe tek më vonë ka zgjedhur të mbesë në heshtje, kjo nuk nënkupton se strategjia e tij e re e mbrojtjes do të kishte ndikim në deklaratat të cilat ai tashmë i ka dhënë. KPPK-ja nuk përjashton përdorimin e deklaratave të tilla të mëparshme të të pandehurit.

C. Konstatimi i gjendjes faktike

40. Gjykata e Apelit nuk pajtohet me pretendimin e palës ankuese se Gjykata e Qarkut ka konstatuar rrethanat faktike gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë.

41. Lidhur me kundërshtimin nga ana e mbrojtjes përkitazi me vlerësimin e shumës së përgjithshme të mallrave të kontrabanduara dhe taksave të shmangura, ky kolegji vëren se është kryesisht privilegj i trupit gjykues të bëjë vlerësime të tilla. Roli i rishikimit të ankesës duhet të përkufizohet së pari dhe më së shumti në përcaktimin e asaj se a janë bërë vlerësimet sipas normave relevante procedurale dhe normave të drejtës materiale dhe që kjo të mos bëhet në mënyrë arbitrare. Është parim i përgjithshëm i procedurës se apelit që Gjykata e Apelit duhet t'i japë një margjinë respekti konstatimit të gjendjes të cilin e ka bërë trupi gjykues për shkak se është trupi gjykues ai i cili është më së miri i pozicionuar të bëjë vlerësimin e provave. Gjykata Supreme e Kosovës përkitazi me këtë ka zbatuar standardin që *"mos të shqetësojë konstatimet e trupit gjykues përveç nëse provat në të cilat mbështetet trupi gjykues mund të mos jenë pranueshme nga asnjë gjykatë e arsyeshme e faktit, ose kur vlerësimi i saj ka qenë tërësisht i gabuar"* (Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZI 84/2009, 3 dhjetor 2009, paragrafi 35; Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZI 2/2012 24 Shtator 2012, paragrafi 30). Kjo përjasje e Gjykatës Supreme pasqyron një parim të procedurës së apelit e cila zbatohet – edhe pse me ca ndryshime - jo vetëm në të drejtën anglosaksone por gjithashtu edhe në juridiksionin e të drejtës civile si dhe në procedurën e të drejtës penale ndërkombëtare (shih p.sh. *Gjykata Supreme e Irlandës, Hay versus O'Grady [1992] IR 210; Gjykata Federale e Drejtësisë Gjermani, BGHSt10, 208 (210) ; Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, Prokurori kundër Kupreskiq et al,*

IT-95-16-A, Aktgjykimi mbi ankesat, para. 28 et seq.). Kolegji nuk konstaton ndonjë shkelje në lidhje me vlerësimin e fakteve tek gjykata e shkallës së parë.

42. Kolegji thekson se dokumentet në bazë të cilave Gjykata e Qarkut ka bërë vlerësimin e vet nuk janë kontestuar nga avokati mbrojtës gjatë fazës së gjyqimit. Faktikisht, as nuk ka asgjë në ato dokumente që i bën ato të kontestueshme sepse ato dokumente paraqesin vetëm një përmbledhje llogaritjesh të bazuara në kontabilitetin e kompanive të përfshira si dhe të dokumenteve që kanë të bëjnë me deklaratat e bëra në kufi. Është padyshim e gabueshme të pretendohet, siç e ka bërë avokati mbrojtës, se nuk ka prova të cilat mbështesin konkludimin e Gjykatës së në këtë drejtim. Në aktgjykimin e kontestuar ekzistojnë referenca të qarta që kanë të bëjnë me propozimet për të pranuar prova me shkrim: dokumentet kryesore – të datës 27 korrik 2012, të cilat gjykata i ka marrë parasysh (shih fq. 17, fq. 8.1).

43. Ushtruesi i ankesës gabon kur deklaron se akti i pastrimit të parave nuk është përshkruar si duhet në aktgjykim. Në fakt, edhe vetë ushtruesi i ankesës i referohet një pjese të këtij përshkrimi: **J.P.** i këmbente valuta për pjesëtarë të tjerë të bandës. Por thuhet edhe më shumë - në aktgjykim aktivitetet e pastrimit të parave janë përshkruar si këmbim dhe transaksione me të holla të cilat ishin të njohura se kishin origjinë nga aktivitetet kriminale, poashtu i pandehuri mbante shënime të pagesave për stafin dhe policinë kufitare, ai operonte me sasi të mëdha të parave të gatshme (duke i mbledhur ato nga pompat e benzinës ku shiteshin produkteve e kontrabanduara të naftës shiteshin) dhe duke i kthyer këto në të holla "legjitime" në llogari të ndryshme (shih faqet 21-24 të Aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut).

44. Ky kolegji nuk pajtohet me kritikën e avokatit mbrojtës se provat janë vlerësuar gabimisht. Ushtruesi i ankesës jo vetëm që nuk pajtohet me konstatimet e Gjykatës së Qarkut por nuk është në gjendje të ofrojë asnjë analizë për t'i rrëzuar ose së paku minuar këto konkluzione. Meqë nuk ka gabime procedurale të pranishme të cilat do kërkonin të kundërtën, duhet pajtuar me vlerësimin të cilin e ka bërë Gjykata e Qarkut sepse i mbetet kryesisht atyre për të vlerësuar provat. Kjo gjithashtu ka të bëjë me vlerësimin e faktit se i pandehuri a dinte për prapavijën kriminale të parave me të cilat ai punonte apo jo. Gjykata e Qarkut ka konstatuar me të drejtë se **J.P.** i jo vetëm që dinte për ato aktivitete kriminale bazë në përgjithësi, por në fakt ka qenë pjesë e skemës me funksion të veçantë që kishte të bënte me të ardhura nga shitja e mallrave të kontrabanduara.

45. Gjykata e Apelit e konsideron jomeritor qëndrimin e avokatit mbrojtës se vlerësimi të cilin e ka bërë gjykata përkitazi me sasinë dhe vlerën e mallrave të importuara nuk mbështetet në prova, por bazohet në supozime dhe kjo nuk është bindëse as teorikisht, sepse nuk ka pasur kapacitete për të mbajtur sasinë e pretenduar të produkteve të naftës në veri të Kosovës dhe se as afër nuk ka pasur konsumim të produkteve të naftës në atë zonë. Spekulumet e mësipërme të avokatit mbrojtës nuk mbështeten nuk mbështeten në asnjë fakt, ndërsa konstatimet Gjykatës së Qarkut të cilat kritikohen bazohen në deklaratimet e importit të produkteve të naftës, por gjithashtu edhe në dokumentacionin e konfiskuar nga kompanitë e përfshira në këtë vepër, i cili tregon shitjen e

produkteve të kontrabanduara të naftës në Kosovë. Duhet të theksohet se shitja e produkteve të naftës në veri të Kosovës nuk e ka qenë e kufizuar etëm për banorët lokalë. Prandaj është e pakuptimtë të thuhet se banorët lokalë nuk kanë mundur të konsumojnë të gjithë gjoja sasinë e kontrabanduar të produkteve të naftës.

46. Nuk ka asnjë dëshmi që mbështet mendimin e paraqitur të palës ankuese se mallrat kanë kaluar kufirin e Kosovës vetëm në letër apo se ato janë ri-eksportuar së paku menjëherë dhe kthyer për në Serbi. Kjo nuk është asgjë tjetër përveç se një spekulim tjetër avokatit mbrojtës që është në kundërshtim me provat e mbledhura (së pari dhe më kryesorja dokumenti që përmendet në propozimin e Prokurorisë për pranimin e provave me shkrim: dokumentet kryesore të cilat janë paraqitur në Gjykatën e Qarkut më 27 korrik 2012).

47. Argumenti i ushtruesit të ankesës se veprimet e **J.P.** nuk mund të konsiderohen pastrim parash sepse veprimet e tij ishin publike dhe të dokumentuara paraqet një kuptim të gabuar të ligjit. Operacionet të cilat përbëjnë pastrim parash shumë lehtë mund të jenë (dhe ato janë me të vërtetë kryesisht) transaksione normale financiare. Çfarë i bën ato transaksione kriminale është origjina e aseteve të përdorura dhe qëllimi i transaksioneve. Argumentet se nuk ka qenë në dijeni për aktivitetet kriminale bazë dhe nuk kishte të bënte asgjë me to, u rrëzuan nga analiza e bazuar mirë dhe qëndrueshme që është dhënë në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut. Kuptimi i ushtruesit të ankesës se vepra penale e pastrimit të parave duhet kombinuar me korrupsionin është diçka arbitrare dhe nuk ka kurrfarë mbështetje. Me pastrimin e parave tentohet që të ardhurat nga burimet kriminale të tregohen si të ardhura legale dhe kjo nuk duhet domosdo të jetë e lidhur me krimet e korrupsionit. Mundësia që në disa raste mund të ndodhë që skemat e pastrimit të parave të kombinohen edhe me korrupsionin nuk e ndryshon këtë.

48. Sipas avokatit mbrojtës fakti se i pandehuri ka mbajtur një zyrë të pa licencuar të këmbimit valutor nuk duhet interpretuar në dëm të tij. Kjo është e vërtetë, por thënë shkurt, kjo nuk është interpretuar në dëm të të pandehurit. Fakti që J.P.i vepronte si këmbyes i valutave (me leje apo jo) është i rëndësishëm për shkak se kjo ka qenë njëra prej mënyrave se si ai kryente operacionet e pastrimit të parave.

D. Aplikimi i të drejtës materiale

49. Gjykata e Apelit nuk është dakord me vlerësimin e avokatit mbrojtës se Gjykata e Qarkut ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale në dëm të të pandehurit. Argumentet e ushtruesit të ankesës në këtë drejtim bazohen në një kuptim të gabuar të ligjit, si dhe në një mosmarrëveshje të thjeshtë me faktet e vërtetuara nga Gjykata e Qarkut. Ky kolegji plotësisht pajtohet me vlerësimin e gjendjes faktike nga ana e Gjykatës së Qarkut. Në mënyrë më të detajuar, Gjykata e Apelit konstaton si në vijim.

50. Gjykata e Qarkut në mënyrë të zellshme dhe përtej dyshimit të arsyeshëm i ka provuar krimet për të cilat **J.P.** i është shpallur fajtor. Një listë e gjatë e provave që e mbështesin shpalljen e tij fajtor për pastrim parash është paraqitur në aktgjykimin e kontestuar (shih faqet

21-23 të aktgjykimit të kontestuar në përshkrimin e provave të paraqitura; dhe faqet 23-24 për vlerësimin e këtyre provave nga Gjykata e Qarkut). Më pas, Gjykata e Qarkut ka shpjeguar se si ka ardhur tek shpallja e **J.P.** fajtor për pastrim parash në bazë të provave të përmendura. Gjykata e Qarkut gjithashtu ka dhënë arsytim adekuat pse veprimet e të pandehurit përbëjnë veprën penale të krimit të organizuar (shih faqet 24-25 të aktgjykimit të kontestuar).

51. Argumenti i avokatit mbrojtës se pastrimi parave nuk mund të jetë vepër penale bazë që shkon bashkë me veprën penale të krimit të organizuar është poashtu i gabuar. Avokati mbrojtës pohon se **J.P.** i nuk mund të ngarkohet me veprën penale të krimit të organizuar, sepse ai nuk është akuzuar për ndonjë krim për të cilin parashihet dënimi i detyrueshëm minimal. Mbrojtja argumenton se vepra penale bazë që shkon së bashku me krimin e organizuar duhet të ketë një dënim minimal prej katër vitesh burgim, por në rastin konkret dënimi minimal për pastrimin e parave është burgimi minimal i përcaktuar sipas KPK-së (30 ditë). Sugjerimi i mësipërm i ushtruesit të ankesës është i gabuar, sepse termi “i dënueshëm me burgim prej së paku” duhet kuptuar më tepër si “të jesh në gjendje të dënohesh me” një dënim specifik sesa të kuptohet “i dënueshëm me një minimum “ të një dënimi specifik (shih në këtë aspekt praktikën e mëparshme të Gjykatës së Apeli, p.sh. Aktvendimi në rastin Nr. PN 496/13 (G.) i datës 19 qershor 2013,ku më tutje përmendet një interpretim i mëparshëm të ligjit nga ana e Gjykatës Supreme në një rast identik).

52. Edhe pse argumentet e avokatit mbrojtës nuk janë në gjendje të bëjnë revokimin e zbatimit të drejtës materiale nga Gjykata e Qarkut, Gjykata e Apelit vëren se zbatimi i të drejtës materiale nga ana e Gjykatës së Qarkut vërtetë ka qenë i gabuar dhe se aktgjykimi i kontestuar duhet të modifikohet në këtë drejtim.

53. **J.P.** është dënuar për dy vepra penale: krim të organizuar në kundërshtim me nenin 274 (1) dhe (2) KPK dhe pastrim parash në kundërshtim me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2 mbi Pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale. Gjykata Supreme e Kosovës në një gjykim të mëparshëm ka theksuar se vepra e krimit të organizuar kërkon kryerjen e një vepre penale "bazë", përveç veprës së krimit të organizuar sipas nenit 274 të KPK-së . Formulimi i përdorur gjatë gjithë nenit 274 të KPK-së përcakton qartë se kryerja e një vepre bazë është element përbërës i kësaj vepre. Përndryshe, një individ mund të shpallet fajtor për të njëjtën vepër, duke qenë pjesë e të dy veprave penale, e krimit të organizuar dhe veprës penale bazë. Kjo situatë mund të përbëjë shkelje të ndalimit të shqiptimit të një dënimi të dyfishtë për një vepër të vetme¹. Gjykata e Apelit pajtohet me interpretimin e mësipërm nga ana e Gjykatës Supreme dhe konstaton se ka nevojë për modifikim të aktgjykimit kontestues. Në rastin konkret vepra penale e krimit të organizuar e përfshin si pjesë përbërëse veprën penale të pastrimit të parave si vepër penalë 'bazë' të sajën. Prandaj **J.P.** është fajtor për kryerjen e veprës penale të krimit të organizuar në kundërshtim me nenin 274 (1) dhe (2) të KPK-së në lidhje me veprën

¹ Shih aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës në lëndën numër Ap-Kz 61/2012 e datës 2 tetor 2012, par. 48.

penale të pastrimit të parave në kundërshtim me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2 mbi Pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale. Për këtë arsye dhe duke marrë parasysh kompetencën e diskrecionit të Gjykatës së Apelit në bazë të nenit 420 (1) 4) dhe neni 426 (1) të KPPK-së, kualifikimi ligjor i veprave penale që i atribuohen J.P. duhet të ndryshohet në përputhje me këtë që u tha.

E. Dënimi

54. Kolegji vëren se KPPK-ja në fuqi i jep të drejtë Gjykatës së Apelit ta rishqyrtojë përcaktimin e dënimit nga gjykatat e shkallës së parë. Megjithatë, kolegji gjithashtu pranon se përcaktimi i dënimit është detyrë e parë dhe kryesore e trupit gjykues i cili në përgjithësi duhet të respektohet nga ana e Gjykatës së Apelit. Gjyqtarët e Trupit Gjykues kanë diskrecion të gjerë gjatë përcaktimit të një dënimi adekuat për shkak të obligimit të tyre t'i individualizojnë dënimet në mënyrë që t'ua përshtatin rrethanave të akuzuarit dhe seriozitetit të krimit. Fushëveprimi i rishikimit për Gjykatën e Apelit është pra i kufizuar prandaj ky kolegji i apelit është i mendimit se duhet të ndërhyjë në konstatimet e trupit gjykues vetëm në rast se trupi gjykues gjatë dhënies së vendimit mbi dënimin tejkalon autorizimet e veta sipas ligjit (neni 404 (5) KPPK), kur nuk e cakton dënimin si duhet (neni 406 (1) KPPK) ose kur shqipton një dënim i cili në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si i drejtë; kjo e fundit qëndron kështu nëse dënimi, në bazë të dënimeve të mundshme që janë dispozicion, është në mënyrë të pajustificueshme i lartë apo i ulët.

55. Si pasojë e konstatimeve në pjesën III D të këtij aktgjykimi, kolegji vëren se gjykata i shkallës së parë ka dënuar gabimisht të pandehurin përkitazi me dënimet e veçanta të veprave penale të krimit të organizuar dhe pastrimit të parave. Gjykata e Qarkut e ka dënuar **J.P.** in me katër vjet burgim dhe gjithashtu me gjobë prej 1.000 euro për pastrimin e parave, dhe për tetë vjet burgim dhe poashtu gjobë prej 1.000 euro për krim të organizuar. Prandaj, aktgjykimi i kontestuar duhet të modifikohet dhe **J.P.** i duhet të dënohet me një dënim të vetëm për veprën penale të krimit të organizuar në lidhje me veprën penale të pastrimit të parave.

56. Gjatë shqiptimit të dënimit **J.P.** për veprën penale të krimit të organizuar, Gjykata e Apelit gjen se ekzistojnë në veçanti rrethana lehtësuese në kuptim të nenit 66 (2) të KPK-së, të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet duke shqiptuar një dënim më të butë. Së pari duhet të theksohet se veprimet e pastrimit të parave nga të ardhurat që kanë për burim nga aktivitete kriminale mund të bien nën amnisti. Vepra penale e kontrabandimit të mallrave në kundërshtim me nenin 273 (1) të KPK-së, ajo e shmangies fiskale në kundërshtim me nenin 249 (1) dhe (2) të KPK-së, dhe shmangies mashtruese nga doganimi i importit dhe akcizës në kundërshtim me nenin 298 të Kodit të Doganave dhe të Akcizës – veprat themelore bazë nga të cilat kanë rrjedhur të gjitha të ardhurat kriminale - mbulohen secila nga neni 3 (1.2.8.4), (1.2.8.3) dhe (1.1.13.12.3) i Ligjit për Amnistinë. Prandaj mund të jetë rasti që **J.P.** do të dënohet për pastrimin e të ardhurave kriminale të përmendura më lart, por personat të cilët në fakt i kanë kryer krime të përmendura më lart ecin të lirë për shkak të amnistisë. Pavarësisht nga faktet që vepra penale e

pastrimit të parave kriminalizohet si keq bërje në vetvete dhe shpallja e amnistisë nuk ia humb natyrën kriminale veprave penale të kontrabandimit të mallrave, të shmangies nga tatimet, doganat apo akcizat, Gjykata e Apelit është e mendimit se për hir të pajtimit të cilin e sjell ligji i amnistisë, por gjithashtu për hir të ndershmërisë, dënimi i shqiptuar ndaj **J.P.** duhet të reduktohet në mënyrë të ndjeshme. Si faktorë tjerë në favor të zbutjes së dënimit, Gjykata e Apelit vëren se roli i **J.P.** ishte i kufizuar në transaksionet me të ardhurat nga veprat penale bazë. Edhe pse **J.P.** ishte pa dyshim anëtar i grupit kriminal, ai në mënyrë evidente nuk kishte kontroll të përgjithshëm apo efektiv mbi politikat e këtij grupi në atë se çfarë duhet bërë me të ardhurat e krimit, duke qenë thjeshtë person i cili ka kryer detyrat që ia dhënë atij nga pjesëtarë me pozita më të larta në grup. Kolegji e percepton atë vetëm si një figurë të parëndësishme në skemën e përgjithshme kriminale. Gjithashtu, fitimi i tij personal nga krimi i kryer ishte shumë modest.

57. Për veprën penale të krimit të organizuar në kundërshtim me nenin 274 (1) dhe (2) të KPK-së, dënimi minimal i paraparë është burgim prej shtatë vjetësh. Në mbështetje të nenit 67 (1.2) të KPK-së, kur kushtet e parapara në nenin 66 të KPK-së ekzistojnë, gjykata mund të zbusë dënimin me burgim prej një viti, në qoftë se periudha prej të paktën tre vjet parashihet si afat minimal burgimi për një vepër penale. Kolegji që është nënshkruar më poshtë konstaton se, duke marrë parasysh faktorët lehtësuese të përshkruar në paragrafin 55 të këtij aktgjykimi dhe kufijtë e përcaktuar në nenin 67 (1,2) të KPK-së, **J.P. i** duhet të dënohet me burgim prej katër vjet dhe me një gjobë prej 1,000 Euro.

58. Më tej, meqë akuza për pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328 (2) të KPK-së kundër **J.P.** duhet të refuzohet, aktgjykimi i kontestuar duhet rrjedhimisht poashtu të modifikohet në drejtim të dënimit të shqiptuar ndaj tij për këtë krim duke ia anuluar këtë dënim.

59. Siç vërehet nga lart, **J.P.** do të dënohet me një dënim të vetmin. Prandaj, aktgjykimi i kontestuar duhet të anulohet përkitazi me dënimin unik të shqiptuar kundër tij.

60. Gjykata e Apelit vëren se edhe pse akuza për veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve në kundërshtim me nenin 328 (2) të KPK-së kundër **J.P.** është refuzuar, kjo nuk e liron të akuzuarin nga të gjithë pasojat e dënimit të parë në këtë vepër penale nga ana e Gjykatës së Qarkut e atëhershme e Mitrovicës. Gjegjësisht, me aktgjykimin e kontestuar është bërë konfiskimi i armës dhe i municioni që janë gjetur të në posedim të paautorizuar nga J.P.i. Sipas nenit 9 të Ligjit për Amnisti, pavarësisht nga zbatimit i amnistisë sipas këtij ligji për çfarëdo vepre penale, nëse një gjësend është konfiskuar në përputhje me ligjin gjatë procedurës penale duke u bazuar në tërësi ose pjesërisht në veprën penale përkatëse, personi i cili amnistohet nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e gjësendit të konfiskuar. Prandaj, Gjykata e Apelit e vërteton vendimin e Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës për të konfiskuar në pajtim me nenin 328 (5) të KPK-së armën dhe municionin që janë kapur në posedim ilegal të **J.P.**.

61. Në mbështetje të nenit 60 (1) dhe (2) të KPK-së, Gjykata e Qarkut ka bërë konfiskimin e dy automjeteve dhe parave të gatshme në monedha Euro dhe dinarë serbe që i janë marrë të pandehurit gjatë arrestimit të tij më 17 maj 2011. Gjykata e Apelit është e bindur se në bazë të dëshmive të (shih paragrafin 7.1 të aktgjykimit të kontestuar) ka arsye të mjaftueshme për të besuar se paratë që janë gjetur tek **J.P.** i pas arrestimit të tij kanë me të vërtetë burimin tek kryerja e veprave penale dhe për këtë arsye konfiskimi i aseteve është i ligjshëm. Megjithatë Gjykata e Apelit nuk është e pajtimit me konkludimin se edhe automjetet që i janë marrë **J.P.** mund të konfiskohen duke u bazuar në nenin 60 (1) ose (2) të KPK-së. Nuk ka kurrfarë indikacioni çfarë do qoftë në aktgjykimin e kontestuar se automjetet në pronësi të **J.P.** duhet të konsiderohen se kanë burimin e tyre tek aktivitetet kriminale. Edhe pse disa nga provat që i referohen pastrimit të parave të kryer nga **J.P.** janë marrë me të vërtetë në ato automjete, kjo nuk është e mjaftueshme për t'i kthyer automjetet në objekte të destinuar për t'u përdorur në kryerjen e një veprave penale. Prandaj, aktgjykimi i kontestuar duhet të modifikohet në këtë drejtim.

62. Për arsyet e mësipërme, Gjykata e Apelit vendos si në dispozitiv.

E përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë kjo e autorizuar. Aktgjykimi i arsyetuar kompletohet dhe nënshkruhet më 19 nëntor 2013.

Tore Thomassen
Gjyqtar i EULEX-it

Anëtare e kolegjit

Anëtare e kolegjit

Procesverbal mbajtës

Annemarie Meister
Gjyqtare e EULEX-it

Tonka Berisha
Gjyqtare

Andres Parmas
Zyrtar ligjor i EULEX-it

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PaKr 4/2013
22 tetor 2013